



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 17, paragrafët 7, 8, 9 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, dhe shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 2777/16 dt. 10.06.2016, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2016, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM TË LAGJES
"SOFALIA" NË PRISHTINË 2016-2024

Neni 1

Miratohet Vendimi i Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", në Prishtinë, 2016-2024.

Neni 2

Miratimi i planit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet pas periudhës së shqyrtimit publik, raportit, analizës dhe inkorporimit të propozimeve të dala nga shqyrtimi publik.

Neni 3

Me Planin Rregullues të Hollësishëm nga neni 1 i këtij Vendimi planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Plani nga neni 1 i këtij Vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 5

Territori i Planit Rregullues i Hollësishëm i lagjes „Sofalia” ka sipërfaqe = 250 Ha, ky plan kufizohet me Matin 1, Vellusha, Tasligje, dhe Parkun e Gërmisë.

Neni 6

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë siguruar nga buxheti i komunës së Prishtinës, në bazë të kontratës të lidhur në mes të komunës së Prishtinës dhe NNSH "Vizion Project" – Prishtinë, me numër identifikues 616 13 068 221, dt. 11.6.2013, kontraktorit të përzgjedhur nga konkursi i projektimit sipas Ligjit Nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës).

Neni 7

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 8

Plani Rregullues i Hollësishëm sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 9

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Neni 10

Organet e tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Plani nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 11

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.nr.031-247790, më 04.10.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

ARSYETIM
I VENDIMIT PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË PLANIT
RREGULLUES "SOFALIA"

Sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-035-25404, të dt. 12.7.2012, ka filluar hartimi i ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues "Sofalia".

Bazuar në këtë vendim, Ligjin për planifikim hapësinor nr. 2003/14, dt. 3.7.2003, dhe Udhëzimin administrativ mbi elementet themelore të planit rregullues urban, nr. 41, dt. 4.3.2005, Kryetari i komunës ka përgatitur detyrën projektuese për hartimin e këtij niveli të planifikimit.

Sipas detyrave projektuese të hartuara nga Kryetari i komunës, Departamenti i Prokurimit ka publikuar ofertat për zgjedhjen e kompanisë projektuese, dhe pas përfundimit të këtyre procedurave konkurruese, është përzgjedhur kompania fituese për hartimin e këtij plani NNSH "Vizion Project" – Prishtinë. Mbi këtë bazë është nënshkruar kontrata me numër identifikues 616 13 068 221, dt. 11.6.2013.

Për hartimin e këtij plani, sipas dispozitave ligjore, gjatë takimeve dhe punëtorive, përveç përfaqësuesve të kompanisë projektuese, është angazhuar edhe stafi përgjegjës profesional i Komunës së Prishtinës, si dhe këshilltarë profesionalë. Në disa takime pjesëmarrës kanë qenë edhe përfaqësues të komunitetit.

Gjatë punës së hartimit të këtij plani, kompania hartuese fillimisht ka dorëzuar planin dinamik për hartimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues "Sofalia", konform afatit ligjor të paraparë me kontratën e lartshënuar dhe atë:

Faza e parë:

- I. Incizimi gjeodezik;
- II. Identifikimi i informatave që duhet grumbulluar;
- III. Analiza e pjesëmarrësve;
- IV. Përgatitja e profilit urban;
- V. Vlerësimi i situatës në lokacion dhe
- VI. Konsultimet për procesin e planifikimit.

Faza e dytë:

- I. Opsionet e zhvillimit;
- II. Prezantimi i zgjidhjeve të mundshme, konkretisht katër skenarë dhe
- III. Hartimi i planit rregullues.

Faza e tretë:

- I. Diskutimi, shqyrtimi publik dhe miratimi i planit.

Kompania hartuese e lartcekur, ka vazhduar me punën e mëtutjeshme rreth hartimit të këtij plani dhe gjatë kësaj periudhe, përkatësisht fazës së parë, të dytë dhe të tretë, janë mbajtur shumë takime.

- Takimi i parë – Takim njoftues dhe rreth dinamikës, më 3.8.2013;
- Takimi i 2-të - Njoftimi me dokumentacionin dhe propozimet, më 7.8.2013;

- Takimi i 3-të – Problemet me infrastrukturë, më 20.8.2013;
- Takimi i 4 -t - Problemet e identifikuara dhe prezantimi i profilit urban, më 19.9.2013;
- Takimi i 5-të - Prezantimi i tre skenarëve, më 21.10.2013;
- Takimi i 6-të - Prezantimi i katër skenarëve, më 28.10.2013;
- Takimi i 7-të - Prezantimi i çështjeve teknike, më 8.4.2014;
- Takimi i 8-të - Takim pune - propozimi, inkorporimi me PZHU-në, më 11.6.2014;
- Takimi i 9-të - Prezantimin i Profilit urban, më 8.5.2014;
- Takimi i 10-të, me qytetarë - Dëgjimi i publik në shkollën “Gjin Gazulli”, më 20.6.2014;
- Takimi i 11-të - Takim pune, shqyrtimi i ankesave të qytetarëve pas dëgjimit publik, më 7.7.2014;
- Takimi i 12-të - Shqyrtimin i ankesave, me theks të veçantë trasetë e rrugëve, më 14.7.2014;
- Takimi i 13-të - Harmonizimi me PZHU-në, më 11.8.2014;
- Takimi i 14-të - Punëtori me pyetje, komente dhe sugjerime, më 4.9.2014;
- Takimi i 15-të - Prezantimi i projektit, më 9.9.2014;
- Takimi i 16-të - Prezantimi i rrugëve, destinimet, koeficientet, më 17.9.2014;
- Takimi i 17-të - Sqarime për takimin me qytetarë, më 19.9.2014;
- Takimi i 18-të - Përgatitje për prezantim të Planit para qytetarëve, më 23.09.2014;
- Takimi i 19-të - Takimi me qytetarë në shkollën “Gjin Gazulli”, më 25.9.2014;
- Takimi i 20-të - Për rrugën e Sofalisë dhe kushtet e ndërtimit, më 29.9.2014;
- Takimi i 21-të - Sqarimi i gjendjes kadastrale, më 8.10.2014;
- Takimi i 22-të – Takim para mbledhjes së Kuvendit, më 28.10.2014
- Takimi i 23- të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 5.1.2015;
- Takimi i 24-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 8.1.2015;
- Takimi i 25-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 13.1.2015;
- Takimi i 26-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 16.1.2015;
- Takimi i 27- të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 21.1.2015;
- Takimi i 28- të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 28.1.2015;
- Takimi i 29-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 5.2.2015;
- Takimi i 30-të - Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 12.2.2015;
- Takimi i 31- të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 16.2.2015;
- Takimi i 32-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 24.2.2015;
- Takimi i 33-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 27.2.2015;
- Takimi i 34-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 2.3.2015;
- Takimi i 35-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 23.3.2015;
- Takimi i 36-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 24.3.2015;
- Takimi i 37-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 25.3.2015;

- Takimi i 38-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 26.3.2015;
- Takimi i 39-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 24.3.2015;
- Takimi i 40-të – Komisioni për shqyrtimin e ankesave, më 21.4.2015.

Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues “Sofalia” ishte pezulluar nga ana e MMPH-së, me njoftimin e dt. 29.11.2013, për shkak të Ligjit të ri të planifikimit dhe akteve nënligjore të cilat do të duhej të nxirreshin dhe për këtë arsye është zgjatur afati i dorëzimit të materialit.

Më 13.10.2014, kompania hartuese e ka dorëzuar materialin (pjesën tekstuale dhe grafike), gjegjësisht këtë propozimplan tek Kryetari i komunës, për ta përcjellë këtë material për Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm. Materiali është dorëzuar në tri kopje të forta dhe 10 kopje elektronike (CD).

Më 30.10.2014, u miratua Vendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues “Sofalia”. Propozimplanin i cekur u lihet në dispozicion për diskutim publik grupeve të interesit, departamenteve, agjencive dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente nga dt. 10.11.2015 deri më 1.12.2015.

Në bazë të Vendimit 01-031-28460, të dt. 24.12.2014 dhe Vendimit 01-031-88112, të dt. 23.4.2015, të Kryetarit të Komunës, formohet komisioni për shqyrtimin e vërejtjeve dhe komenteve të qytetarëve për këtë Plan. Ky komision ka filluar punën më 5.1.2015 për shqyrtimin e vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve të paraqitura nga publiku gjatë shqyrtimit publik. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 18 takime.

Pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura nga publiku, më 27.4.2015, komisioni ka përfunduar dhe dorëzuar raportin. Kompania projektuese ka vazhduar dhe ka përfunduar plotësimet e Planit sipas rekomandimeve të komisionit. Andaj, projekti final “Plotësimi dhe ndryshimi i Planit rregullues “Sofalia”” është i gatshëm të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Menaxhere e Planit rregullues: Mejrushe Sejdullahu, inxh.dipl.ark.

Mbikëqyrës:

Nazife Krasniqi, inxh.dipl.ark,

Makfired Avdullahu, msc.kom,

Msc. Ferit Fazliu, inxh.dipl.ndërt.

Merita Rushiti, inxh.dipl.hid.

Avdurrahman Krasniqi, inxh.dipl.elek.

Daut Humolli, inxh.dipl.mak.

Fatbardha Mehmetukaj, msc. Biol.

Më 7.7.2015.